



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA	
OPK	01/2339/13
2/42	02.08.13



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së punës të Agjencisë kundër korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit me datë **02.08.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-466/13 për z.Hamdi Jaha – Anëtar i Bordit të Kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” Prishtinë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-466-13, për Zyrtarin e lartë, z. Hamdi Jaha – Anëtar i Bordit të Kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-466/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Jaha së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Jaha është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtrroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pasi kanë kaluar afatet administrative për ndryshime të kësaj gjendje dhe ztr. Jaha nuk i ka bërë ndryshimet e nevojshme, Agjencia kundër korrupsionit, në pajtim me nenin 18, paragrafi 5 të Ligjit Nr.04/L-051, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit Jaha i ka bërë edhe shkresën e dytë që quhet Paralajmëruese (Z.D./DPK-01-2210/13), me njoftimin për masat që mund të pasojnë nëse në afat të caktuar nuk



bëhen ndryshimet e gjendjes për të parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Z.Jaha me datë 30.07.2013 në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-2290/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte te “Alba & Dana” sh.p.k., duke autorizuar një person të besuar, për të ushtruar vet funksionin e tij si zyrtar i lartë publik në K.R.M. “Pastrimi”.

Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër korrupsionit

/ Hasan Preteni /

